**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 18 – 8575 – 1-3-6/C140
14 Nr. 1226/18
Dt. 03.12.2018

# KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI**) , dhe

2. **NPSH " AFA-ING "** me seli në **Suharekë** , me **NRB: 70587793 dhe Nr. Fiskal: 6000035952,** si Operatorë Ekonomik, të cilët i përfaqëson: **Avdi Morina,** në tekstin e mëtejmë **SHITËSI - FURNITORI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

**Furnizimi me paisje për zgjerimin e pritjes dhe menaxhimin e rendit**, me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi Nr. | VU644 | 1 | 8 | 85 | 7 | 5 | 1 | 3 | 6 |
| Prokurimi Nr. | 644 | 1 | 8 | 1 | 8 | 8 | 1 | 3 | 6 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me paisje për zgjerimin e pritjes dhe menaxhimin e rendit** sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-181882-136.**

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **20 ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.**

2.2 Vendi i **dorëzimit të furnizimit dhe montimit të pajisjeve do të jetë objekti i Komunës së Vushtrris – hapësirat e Drejtorisë Komunale për Administratë,** në pajtim me Specifikacionin Teknik pjesë e Dosjes së Tenderit. Verifikimi i cilësisë dhe sasisë së **pajisjeve** do të bëhet nga Komisionit të Pranimit të Mallit – Pajisjeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit – Pajisjeve të Autoritetit Kontraktues.

2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që secilën pajisje ta dërgoi – transportoi, me shpenzime dhe mjet transporti të tija, deri te vendi i saktësuar nga Njësia Kërkuese – Shpenzuese. **Një herit Furnizuesi merr për**

**obligim që personelin përgjegjës të objekteve të Administratës Komunale ku do të vendosen pajisjet ti ofroi shërbime të aftësimit dhe informimit të mjaftueshme lidhur me mënyrën e përdorimit dhe funksionimit të pajisjeve të dorëzuar respektivisht montuara.**

2.4 Furnizuesi do të penalizohet me shumën prej 0,25% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të kryerjes së furnimeve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

2.5 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.6 Garancioni për cilësinë e paisjeve do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranim – dorëzimit të **pajisjeve dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve.**

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **3.799,00€( tremijshtatqindnëntdhjetenënt/00€ ).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do ti nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht pas Pranimit të pajisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

**Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(d) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit

(e) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të

---

[17] DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[2] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Saranda Cakaj |
| **Pozita:** | Drejtoreshë për Prokurim Publik |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 03.12.2018 |
| **Vula:** | |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË DREJTORIA PËR PROKURIM PUBLIK UPRAVA ZA JAVNU NABAVKU OPSTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVA

**Për Kontraktuesin - Furnizuesin:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Avdi Morina |
| **Pozita:** | Përfaqësues i : NPSH " AFA-ING " – Suharekë |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 03.12.2018 |
| **Vula:** | |

N.P.SH. AFA-ING 044/241-665 SAMADRAXHË-SUHAREKË

---

[2] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i prokurimit: VU644-18-8575-1-3-6 apo nr. i brendshem: VU644-18-188-136 Titulli: Furnizimi me pajisje per zgjerimin pritjes dhe menaxhimin e rendit-Ri tender

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolona E, ku duhet shkruar çmimi me dy decimale pas presëjes dhjetore

| *Nr.* - | *Përshkrimi i pozicioneve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* | *Çmimi DDP-€* | *Totali - €* |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Aparati per dhenien e biletave (Aparati te lidhet me display ekzistues dhe montor ekzisutes)<br>Touch Screen monitori (22 inq)<br>Mini PC<br>Minimum: CPU Atom 1.8G Procesori<br>Minimum: 2G DDR2 Memory Card;4 USB Port<br>Ethernet Port:10/100 Ethernet port RJ45,InternetAccess i lire<br>Perkrahje multilinguale (shumegjuhesore)<br>Perkrahje deri ne 32 Servise, osederi ne 64 sportele<br>Mundesi qe te behet lidhja pa tela | copë | 1 | 1700.00 | |
| 2 | Printer termik: 80mm Thermal Printer<br>Printeri duhet te jen kompaktibile me sistemi ekzistues qe e kemi ne funksion | copë | *1* | 350.00 | |
| 3 | Kornize prej hekuri, ku mund te vendosen, PC, controlleri, printer termik dhe te gjitha elemente tjera, duhet te jet kompaktibile me kornizen ekzistues qe e kemi ne funksion.<br>- Me dimensione 1250mm(H)*470mm(W)*250mm(D) | copë | *1* | 220.00 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Monitori numerues (Counter Display)<br><br>Single color ,8 karaktera ne displayLED Display: 4 vende per paraqitjen e numrave, me mundesi te ndarjes se ekranit per nevoja te marketingut ose nevoja tjera, | cope | 6 | 100.00 | 600.00 |
| 5 | Manipulatori thirres (Calling manipulator)<br><br>Monitori Liquid crystal, i cili paraqet 6 numra<br>Kater numra per bileten e qytetarit dhe 2 numra per personin qe eshte i ardhshmi ne rradhe.<br>21-key pad me 21 funksione ne Panel perfshifunkcionet " Thirrja", "Rithirrja", "Transferi" etj.<br>Paisjet duhet te jen kompaktibile me sistemi ekzistues qe e kemi ne funsion | copë | 6 | 100.00 | 600.00 |
| 6 | Konverteri i signalit (Signal Converter)<br>Konvertori i signalit nga RS232 ne signalin RS485-koverteri duhet te jet i integrauar apo edhe jashte shtepizes eshte opcioni hapur, te kete porte rezerv ne rast djegeje te zavdesohet me porte ekzistues pa patur nevoje qe te ndrrohet conevteri | copë | 1 | 50.00 | 50.00 |
| 7 | Software<br>-Paketa e Software-it Operacional<br>-Perkrahje e shumëgjuhësisë<br>-Perkrahje e menysë me shumenivele<br>Sistem iraportimit statistikor | copë | 2 | 50.00 | 100.00 |

AFA-ING

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Softwer per lidhjen<br>-Lidhja me Monitorët kryesore (Main display) obligative.<br>- Të mundësohet lidhja me TV LCD ose Plazma. | copë | 1 | 50.00 | 50.00 |
| 9 | Paket digjitale per ndezjen vet ne pune te sistemit<br>-Sistemi duhet te startoj ne pune ne ora 8:00<br>dhe te fiket ne ora 16:30 | copë | 4 | 10.00 | 40.00 |
| 10 | Splitier per ndarjen e sinjalit ne vende te ndryshem | copë | 1 | 9.00 | 9.00 |
| 11 | Kabull per bartjen e video sinjalit 20m | copë | 4 | 20.00 | 80.00 |
| | **TOTALI I PËRGJITHSHËM :** | | | | 3,799.00 |

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|---|
| EMRI I OE: | NPSHAFAING |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Avdi Moirna |
| NËNSHKRIMI: | |
| DATA: | 12.11.2018 |
| VULA: | |